



THIRRJE

për përzgjedhjen e gjashtë produkteve për kampanjë marketingu

Qendra për Menaxhim me Ndryshime nga Shkupi, në bashkëpunim me Institutin për të Drejtat e Njeriut, Fondacionin Egalite dhe Qendrën për Studime Krahasuese dhe Ndërkombëtare - Tiranë, po zbaton projektin "Zhvillimi i mikro-ndërmarrjeve të grave në zonën ndërkufitare" i cili realizohet në kuadër të "Programit për bashkëpunim ndërkufitar të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shqipëri për 2014 dhe 2015".

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rrisë konkurrencën e grave dhe të forcojë sipërmarrjen e grave në rajonin e Pollogut dhe të Elbasanit dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla të grave në zonën ndërkufitare.

Në kuadër të projektit, më 09.05.2020, u shpall thirrja për përzgjedhjen e gjashtë produkteve nga rajoni i Pollogut dhe ai i Elbasanit, për të cilin planifikohet një fushatë marketingu në rajonin ndërkufitar dhe rajonal. Thirrja është e hapur për të gjitha kompanitë në pronësi të grave nga rajoni i Pollogut dhe Elbasanit.

QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrje është promovimi i produkteve të grave sipërmarrëse nga rajoni ndërkufitar i Pollogut dhe Elbasanit. Mbështetja do të mundësojë tregtimin e gjashtë produkteve që kanë potencialin më të madh për eksport dhe promovim në tregjet ndërkombëtare. Përzgjedhja e produkteve do të bëhet sipas kriterëve të paracaktuara.

Një fushatë e plotë për marketing do të zhvillohet për produktet e zgjedhura, duke filluar me:





- përgatitja e dizajnit për produktet,
- përgatitja e një video reklamuese dhe
- promovimi i produkteve në tregjet ndërkombëtare dhe vendase përmes mediave sociale.

Kjo mbështetje zbatohet për të inkurajuar një akses më të madh të grave sipërmarrëse nga rajoni i Pollogut dhe Elbasanit në tregjet lokale dhe rajonale dhe promovimin e produkteve të tyre.

PËRMBAJTJA E AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA

Kompanitë e interesuara të grave pritet të paraqesin aplikime duke shpjeguar tiparet e produktit me të cilin marrin pjesë në thirrje.

Produktet e propozuara duhet të përmbajnë këto karakteristika:

- Përshkrim i produktit;
- Qëllimi dhe funksionaliteti i produktit
- Përbërja dhe dimensionet
- Teknika për të bërë produktin
- Kapaciteti për të zgjeruar prodhimin
- Shpjegimi i mënyrës aktuale të reklamimit dhe shitjes
- Fotografi e produktit

LOKACIONI

Kompanitë që marrin pjesë në thirrje duhet të jenë nga rajonet ndërkufitare Pollog dhe Elbasan. Fushata e marketingut do të zbatohet në rajonin ndërkufitar dhe më gjerë në rajon.





KRITERIUMET PËR PJESËMARRJE NË THIRRJE

Kompanitë që paraqesin aplikacionin duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë një person juridik në pronësi të një gruaje
- Të jetë e regjistruar në rajonin e Pollogut dhe të Elbasanit
- Të paktën një vit i funksionimit të ndërmarrjes përpara datës së publikimit të kësaj thirrje
- Formulari i aplikimit të jetë i plotësuar mirë (Shtojca 1)
- Të kenë kapacitetin për të zgjeruar të paktën 10% të prodhimit.

APLIKIMI DUHET TË PËRMBAJË DOKUMENTACIONIN NË VIJIM :

- ✓ Formular për aplikim (shtojca 1)
- ✓ Llogari rrjedhëse
- ✓ Fotografi nga produkti





MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

Aplikimet duhet të dorëzohen me postë elektronike në: info@cup.org.mk; cc: jasna.pajkovska@cup.org.mk, jo më vonë se 15.06.2020, deri ora 16:00. Titulli i postës elektronike duhet të shënohet me : Aplikacioni_CBC.

Pas pranimit të aplikacioneve, konfirmohet në mënyrë elektronike se aplikacioni është pranuar.

QMN, në bashkëpunim me Institutin për të Drejtat e Njeriut, Fondacionin Egalite, dhe Qendrën për Studime Krahasuese dhe Ndërkombëtare, rezervon të drejtën të kërkojë informacion shtesë për propozime nga aplikantët që ata i konsiderojnë të nevojshme për vlerësimin.

SQARIME SHITESË

Pyetje shtesë dhe kërkesa për sqarime në lidhje me paraqitjen e kërkesave për grante mund të dërgohen në: jasna.pajkovska@cup.org.mk, jo më vonë se 12.06.2020.

KRITERIUMET PËR VLERËSIM DHE PËRZGHEDHJE

Produktet e propozuara duhet të përputhen me këtë thirrje. Propozimet do të vlerësohen nga një Komision i formuar për qëllimet e këtij aktiviteti. Përzgjedhja e kompanive do të bëhet në bazë të kritereve të paracaktuara të përzgjedhjes që janë pjesë e kësaj thirrje (treguar më poshtë).

Përzgjedhja e kompanive për të cilat do të zhvillohet një fushatë marketingu për produktet e tyre do të bëhet në fazat e mëposhtme:

- Vlerësimi i aplikacioneve sipas kërkesave themelore;
- Formulari plotësohet siç duhet dhe dokumentacioni shoqërues paraqitet brenda afatit dhe mënyrës së parashikuar në Thirrje;
- Organizata i plotëson kushtet për të aplikuar për thirrje.





Rishikimi i kriterëve të vlerësimit

KRITERIUME	PËRSHKRIMI	MAKS. PIKË
Dedikimi dhe funksioni i prodhimit	Qëllimi i produktit nënkupton se cili është grupi i synuar për të cilin është synuar produkti dhe cila është vlera e tij e përdorimit, d.m.th. cilat nevoja plotësohen nga përdorimi i tij.	25
Përbërja dhe dimensionet	Përbërja e produktit shpjegon materialet nga të cilat është bërë. Produktet natyrore dhe materialet eko renditen më mirë, veçanërisht ato që mund të riciklohen. Ndërsa dimensionet lejojnë vlerësimin e praktikitetit në përdorimin dhe transportin e produktit.	20
Teknikat për përpunimin e prodhimit	Teknikat tradicionale të artizanatit që kërkojnë aftësi dhe njohuri të veçanta vlerësohen gjithnjë e më shumë.	15
Ekspertiza dhe kapaciteti i ndërmarrjes	Kapacitetet njerëzore me përvojë në këtë aktivitet. Një nga parakushtet kryesore është që kompania të ketë burimet njerëzore dhe aftësinë për të zgjeruar prodhimin.	15
Shpjegimi i mënyrës aktuale të reklamimit dhe shitjes	Produktet që janë të njohura në treg dhe kanë krijuar një rrjet të gjerë të konsumatorëve konsiderohen me më pak përparësi në përzgjedhje, d.m.th preferenca do t'u jepet grave sipërmarrëse që kanë një produkt cilësor, por nuk kanë kushte për reklamimin e tyre.	15
Gratë të përfshira në mënyrë aktive në aktivitetet e projektit	Preferenca do t'u jepet grave që janë përfshirë në mënyrë aktive në disa nga aktivitetet e këtij projekti.	10
GJITHSEJ		100



OBLIGIMET E NDËRMARRJEVE

Kompanitë e zgjedhura në pronësi të grave do të kenë këto detyrime gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit:

- ✓ Dorëzoni të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me produktin që do të jetë objekt i një fushate për marketing;
- ✓ Pjesëmarrja në përgatitjen e një video reklamuese për produktin;
- ✓ Të kenë një pjesëmarrje aktive në përgatitjen e materialit me idetë e tyre, sugjerimet dhe të ngjashme;
- ✓ Të bien dakord për një Marrëveshje bashkëpunimi;

Zbatimi i aktiviteteve të fushatës së marketingut duhet të bëhet nga qershori deri në fund të shtatorit 2020.

RENDITJA E AFATEVE

Data për fillimin e dorëzimit të aplikacioneve	09.05.2020 vit.
Afati i dorëzimit të kërkesave për sqarim drejtuar koordinatorit të projektit	12.06.2020 vit.
Data deri kur koordinatori i projektit do të ju përgjigjet kërkesave	14.06.2020 vit.
Afati i dorëzimit të aplikimeve	15.06.2020 vit.
Vlerësimi i propozimeve	16.06.2020 vit.
Njoftimi për shpërndarjen e granteve	16.06.2020 vit.
Nënshkrimi i kontratave	17.06.2020 vit.
Vërejtje: Datat e vlerësimit dhe shpërndarjes së granteve mund të kenë ndryshime.	





TË TJERA

Organizata - Qendra për Menaxhim me Ndryshime – QMN, do të jetë vetëm përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të aksionit.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, ekipi i projektit do të organizojë takime me secilën nga kompanitë e zgjedhura në mënyrë që të sigurojë sqarime për të gjitha aktivitetet gjatë zbatimit të fushatës së marketingut.

